



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASENIT LUMOR VJOSË



Nr. 32 / prot.
8

Vlorë, më 02.04.2026

VENDIM

Nr. 2 , datë 27.03.2026

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS PËR RINOVIM TË LEJES/AUTORIZIMIT,
LIDHUR ME RINOVIMIN E LEJES NR. SERIAL 27 “LEJE PËR
PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR PËR AMBALAZHIM NË
SHISHE OSE ENË”, TË SUBJEKTIT “BEVCOM” SH.P.K.

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, “Për Burimet Ujore”, i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.319, datë 11.06.2025, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujur, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Lumor Vjosë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për rinovim të lejes/autorizimit, lidhur me rinovimin e lejes Nr. Serial 27 “Leje për përdorim burimi ujur nëntokësor për ambalazhim në shishe ose enë”, të subjektit “BEVCOM” sh.p.k, me vendndodhje: Bashkia Këlcyrë, Qarku Gjirokastrë.

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Koordinatat e vendndodhjes së pus-shpimit (KRGJSH):

X= 513192.32 Y= 4462621.03 Z= 80 m.m.n.d

Lloji i aktivitetit dhe qëllimi për të cilin do të përdoret uji: Për ambalazhim në shishe ose enë.

Sasia e ujit që jepet në përdorim: $Q = 6 \text{ l/s}$

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

KRYETARI I KBL VJOSË

EVIS ALLUSHI

